



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËRI I SHQITETIT PËR RININË DHE FËMIJËT



### NËNSHKRUHET MARRËVESHJA ME AADF-NË PËR KODIMIN QË NË KLASË TË PARË DHE NDËRTIMIN E 100 LABORATORËVE SMART

Me qëllim përfshirjen e lëndës së teknologjisë së informacionit dhe kodimit që në klasën e parë, në shkollat publike të vendit, u nënshkrua **memorandumi i bashkëpunimit mes Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF)**. Përmes kontributit të përbashkët me qeverinë shqiptare, do të mbështetet **ndërtimi i 100 laboratorëve SMART në 100 shkolla publike të ciklit fillor të vendit**, para fillimit të vitit shkollor 2022- 2023. Gjithashtu do të mbështetet hartimi i kurikulave të reja të TIK-ut për klasat e I, II, III të ciklit fillor në shkollë vendi, si dhe do të sigurohet platforma plotësuese online për mësimdhënien dhe trajnimin e mësuesve të TIK-ut përgjatë katër viteve.

Mbi 7000 nxënës të klasës së parë në 100 shkollat e përzgjedhura, do të përfitojnë përmes programeve dhe kushteve mësimore të krahasueshme me bashkëmohatarët e tyre në vendet më të zhvilluara evropiane. Ky projekt është hartuar në bashkëpunim mes Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF).



### TË RINJËT E ROSKOVECIT KRIJOJNË KËSHILLI VENDOR RINOR

Një tjetër shembull suksesi i fuqizimit të të rinjve dhe gjithëpërfshirjes së tyre në proceset politikëbërëse të qeverisjes lokale është ajo e **ngritjes së Këshillit Vendor Rinor në Roskovec**, si organ këshillimor që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshillat Vendorë Rinorë do t'i ndihmojnë të rinjtë të ndërtojnë një të ardhme më të mirë dhe të zhvillojnë qëndrueshmërinë e komuniteteve të tyre, nëpërmjet **promovimit të praktikave më të mira demokratike**. Kjo duke i mbajtur përgjegjës zyrtarët e tyre vendorë të zgjedhur dhe duke siguruar transparencë të qeverisë. **Angazhimi i tyre në grupe formale, apo informale rinore**, përfshirja në strukturat e qëndrueshme si Këshillat Vendorë të Rinisë dhe në Këshillin Kombëtar të Rinisë do të jetë një shtysë e fortë për një qeverisje më të mirë. Pjesë e këtij aktiviteti ishte Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, kryetarja e Bashkisë së Roskovecit, Majlinda Bufi, dhe të rinjtë aktiv të Roskovecit. Pas këtij event, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët vizitoi edhe **bibliotekën e qytetit, të rikonstruktuar nga grantet e dhëna gjatë Thirrjes së Parë të AKR-së**, ku është krijuar dhe një ambient i veçantë për të gjithë adhuruesit e librave, si dhe është finalizuar digjitalizimi i librave të bibliotekës që të rinjtë mund t'i aksesojnë online.



### MINISTRI I SHQITETIT PËR RININË DHE FËMIJËT MIKPRET NË SHQIPËRI EKIPIN E TOM

Gjatë muajit maj, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mirëpriti në Shqipëri themeluesin e organizatës jofitimprurëse Tikkun Olam Makers (TOM), Gidi Grinstein dhe drejtuesen për Evropën Qendrore dhe Lindore, Lindjen e Mesme, Afrikën dhe pjesërisht Azinë, Yael Rogers, si një mundësi e mirë **për të prezantuar ekosistemin e industrisë kreative e novative në vend**, laboratorët që mund të përdoren si hapësira prodhimi (maker-space), studentët e interesuar për të qenë pjesë e projektit e po ashtu qendrat/shoqatat që mund të ndihmojnë në ndërlidhjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuara me organizatën TOM. Kjo vizitë u konsiderua si **hap i rëndësishëm në fillimin e projektimit të planeve më novative dhe praktike për zbatimin e TOM në Shqipëri**, me ide novatore dhe qëllime ambicioze për t'i ndryshuar jetën personave me aftësi të kufizuara në të gjithë botën. TOM është **një lëvizje globale që krijon zgjidhje novative dhe praktike** për sfidat e përditshme të njerëzve me aftësi të kufizuara, ose "njohësit e nevojave" siç organizata i quan.



@bora\_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora\_muzhaqi



@boramuzhaqi





REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
KRYEMINISTRIA  
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

# DITARI MUJOR

Maj 2022

5

Ministri i Shtetit  
për Rininë dhe Fëmijët



## MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT MBËSHTET PROJEKTIN "WE ARE ALL MADE OF STARS" PËR TË TRAJNUAR 150 TË RINJ TË TALENTUAR NË FUSHËN E ARTIT

**150 të rinj të talentuar në balet, kanto, aktrim** apo në instrumente të talentuar nga e gjithë Shqipëria u bënë bashkë në projektin e financuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, nëpërmjet AKR-së, "We are all made of stars". Ndër **1600 të rinj që morën pjesë në audicionet** e mbajtura në 6 qytete **Shkodër, Korçë, Elbasan, Durrës, Vlorë dhe Tiranë**, 150 të përzgjedhurit u trajnuan nga dy balerinët dhe kompozitori pjesë e ekipit, për të shfaqur talentet e tyre para një publiku të gjerë. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR), me një fond të përcaktuar nga Buxheti i Shtetit, ka mbështetur idetë novative të të rinjve me hapjen e Thirrjes së Parë për financimin e projekteve të propozuara nga organizatat rinore/ për të rinjtë.



## TRAJNOHET STAFI I AKR-SË NË "MENAXHIMIN E CIKLIT TË PROJEKTIT DHE ZBATIMIT TË METODOLOGJISË LOD"

Në kuadër të **rritjes së kapaciteteve dhe njohjes së metodologjisë LOD**, stafi i Agjencisë Kombëtare të Rinisë pati mundësinë të trajnohet rreth "Menaxhimit të ciklit të projektit dhe zbatimit të metodologjisë LOD nga AKR-ja", përgjatë ditëve 18-20 maj. Kjo bazuar dhe në marrëveshjen e nënshkruar mes Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me UNDP-në, në mars të këtij viti. Përveç menaxhimit të projekteve, **trajnimi u fokusua edhe te vlerësimi dhe monitorimi i projekteve**, duke konkretizuar kështu punën për rininë dhe bashkërenduar praktikën më të mira të Bashkimit Evropian.



## INAUGUROHET QENDRA E PARË RINORE MULTIFUNKSIONALE NË BERAT

Më 9 maj, u inaugurua **Qendra Rinore Multifunktionale** nga kryetari i Bashkisë së Beratit, me prezencën e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Kjo do të jetë një hapësirë e re e dedikuar plotësisht për të rinjtë, duke iu ardhur në ndihmë për **këshillim karriere, këshillim psiko-social, klubet e artit, aktivitetet sportive, aftësim në teknologji e shumë të tjera**.

Gjithashtu do të ofrohen shërbime për **rritjen e kapaciteteve në fusha të ndryshme të aftësisë dhe zhvillimit personal e profesional**, të cilat synojnë të adresojnë çështjet dhe sfidat e të rinjve në qytetin e Beratit. Ambientet e kësaj qendre janë të ndërtuar në mënyrë të përshtatshme që të rinjtë të punojnë në grup, të zhvillojnë aktivitete sportive të mbyllura apo në natyrë, ose të marrin njohuri nëpërmjet literaturës që vetë qendra posedon. Projekti i Qendrës Rinore u zbatua nga **Bashkia e Beratit**, në kuadër të projektit "Qendra Multifunktionale Rinore – një hapësirë e qëndrueshme për të rinjtë", financuar nga programi IADSA.

## KONSOLIDOHEN PROJEKTET E FINANCUARA NGA THIRRJA E PARË PËR PROJEKT-PROPOZIME NGA AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Të rinjtë e Bashkisë Elbasan u trajnuan nga shoqata "Tjetër Vizion", në kuadër të projektit "**Ringjallja e zanave tradicionale përmes brezit të ri**", që financohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) në kuadër të Thirrjes së Parë për Projekt-propozime për rininë.

Një tjetër projekt që po zhvillohet me mbështetjen e AKR-së është dhe projekti "**Fuqizimi i të rinjve pas pandemisë: Sfidat dhe mundësitë**", në kuadër të së cilës, Qendra Evropiane ka zhvilluar aktivitetin e radhës me të rinjtë nga Berati. Aktiviteti dy ditor u përqendrua në **rritjen e kapaciteteve të të rinjve për t'u përballur me dinamikat e tregut të punës**, si dhe u organizuan disa sesione për të rritur ndërgjegjësimin dhe angazhimin e tyre emocional dhe psikik në përballimin e pasojave që solli pandemia COVID-19.

Po ashtu, qendra "Epoka e Re", nëpërmjet projektit "**Rini-Art-Aktivizëm-3**" që financohet nga AKR, ka mbledhur për një periudhë 9-mujore të rinjtë nga Bashkia e Fierit, Patosit dhe Roskovecit, në **kurset e aktrimit, gazetarisë dhe fotografisë**. Kjo me qëllim fuqizimin e të rinjve dhe përfshirjen e tyre në vendim-marrjen lokale.



@bora\_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora\_muzhaqi



@boramuzhaqi